



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 188 Prot.

Tiranë, më datë 13. 03.2025

VENDIM

Nr. 171, datë 13.03.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 13.03.2025:

VENDOSI

1. Mosmiratimin e projektit “*Rikonstruktion i banesës me kod K-040*”, Brenda Kufirit të Qendrës Historike të qytetit të Beratit, me aplikues Z. Jorgo Xuhano dhe zhvillues **Z. Kostandin Plaku me argumentin:**
 - Të eliminohen ndërhyrjet e paautorizuara në pjesën e brendshme të monumentit;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Joli MITROJORGJI

KRYETAR
Blendi GONXHJA

